REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndjesë për vonesën lidhur me fillimin e kësaj mbledhjeje, por për shkak të çështjeve shumë të rëndësishme që ka kjo mbledhje, Këshilli kishte nevojë të konsultonte materialet paraprakisht përpara se t'i relatonte.

Siç jeni në dijeni, një nga prioritetet që ka pasur Këshilli për vitin 2022, në vijim dhe për 2023 është zbatimi i hartës së re gjyqësore dhe kjo mbledhje në fakt i kushtohet hartës së re gjyqësore. Në këtë mbledhje do të parashtrohen pesë akte shumë të

rëndësishme që bëjnë të mundur fillimin e zbatimit të hartës së re gjyqësore për nivelin e apeleve.

Pa humbur kohë unë dëshiroj që t'ia jap fjalën zonjës Ukperaj (si anëtare e grupit të punës lidhur me zbatimin e hartës së re gjyqësore) për çështjen e parë, e cila ka të bëjë me caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Bazuar në kuadrin kushtetues dhe atë ligjor KLGJ është organi përgjegjës për përcaktimin e kompetencave territoriale dhe të madhësisë së gjykatave. Në këtë kuadër është miratuar vendimi i KM nr. 495, datë 21.07.2022, "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave", atë që ne e quajmë harta e re gjyqësore. Në zbatim të këtij vendimi dhe duke marrë masa për vënien në funksionim të asaj çka parashikon harta e re gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr. 505, datë 12.11.2022, "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", i cili përcakton parimet mbi të cilat do të behet riorganizimi i gjykatave të apelit dhe fillimin e tyre më datë 01.02.2023 të funksionimit një gjykate të vetme apeli, me juridiksion të përgjithshëm dhe kompetencë tokësore në gjithë territorin e Republikën e Shqipërisë. Në këtë vendim Këshilli ka parashikuar se numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm do të miratohet me akt të veçantë të Këshillit.

Detyrimi i Këshillit për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë buron nga neni 22 i ligjit 98/2016 i ndryshuar, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon:

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr vazhdimisht ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, me qëllim përmirësimin e efiçencës së gjykatave ose zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përgatit dhe publikon brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e

efiçencës së gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

3. Të paktën çdo pesë vjet Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë dhe nëse është e nevojshme rishikon numrin e gjyqtarëve pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Gjykatës.

4. Procesi i përcaktimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë mbështetet në objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, me qëllim sigurimin e ngarkesës së ekuilibruar të punës së gjithë gjyqtarëve në Shqipëri. Procesi kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në analizën e raporteve vjetore dhe efiçencës së masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet vjetore, sipas pikës 2 të këtij neni.

Procesi i rivlerësimit të shpërndarjes së numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë (neni 22 i ligjit 98/2016) është i ndryshëm nga ai i propozimit për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve (neni 21 i ligjit 98/2016). Ky i fundit kërkon miratimin nga ana e Kuvendit bashkë me propozimin për buxhetin në sistemin gjyqësor. Ndërsa procesi i rishpërndarjes kërkon angazhimin e Këshillit për të rishikuar numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë, duke u bazuar tek totali i numrit të përcaktuar me Dekret të Presidentit, aktualisht në fuqi prej 408 gjyqtarësh.

I qartë për detyrimin ligjor si më sipër, Këshilli ka vlerësuar se rishikimi i numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, ishte proces që lidhej pazgjidhshmërisht me procesin e riorganizimit e rishikimit të madhësisë së gjykatave (harta gjyqësore), sepse të dy proceset kërkonin analizë disa vjeçare të ngarkesës së gjykatave si dhe evidentimin e një normë mesatare ngarkese vjetore të çështjeve të reja për çdo gjyqtar apeli në rastin konkret. Kjo e fundit u llogarit në kuadër të hartës së re gjyqësore, gjatë procesit të analizës së të dhënave statistikore për 3 vite. Në pamundësi për të ndryshuar numrin total të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor, proces i cili tejkalon analizën e vlerësimin e bërë në kuadër të hartës së re gjyqësore, sepse përfshin edhe vlerësimin për Gjykatën e Lartë e Gjykatën Administrative të Apelit, Këshilli tashmë e ka një raport vlerësues të ngarkesës mbi të cilin mund të gjykojë për ndryshimin apo ruajtjen e të njëjtit numër gjyqtarësh në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nga ana tjetër procesi i vlerësimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, duhet të synojë realizimin në mënyrë të ekuilibruar të objektivave si: garantimin e aksesit në drejtësi, uljen e kostove me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike si dhe rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara, qëllime të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 14 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ky proces duhet të mbajë gjithmonë në vëmendje parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 15 të ligjit të sipërcituar, si numrin minimal të gjyqtarëve për gjykatën e apelit (pika 3 e nenit), si dhe një numër mesatar të çështjeve në vit, jo më të vogël se mesatarja për gjyqtar e llogaritur me bazë vjetore, sipas analizës së bërë për 3 vitet e fundit. Numri i gjyqtarëve lidhet pazgjidhshmërisht me krijimin e gjykatave të specializuara dhe rritjen e efiçencës.

Analiza e të dhënave statistikore është bërë hollësisht në Raportin e Vlerësimit mbi hartën e re gjyqësore, ku është konkluduar se Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, do të ketë nevojë për 78 gjyqtarë për të ruajtur mesataren kombëtare të ngarkesës me çështje. Ky numër është i barabartë me numrin e pozicioneve të gjyqtarëve të apelit të alokuar aktualisht në sistemin gjyqësor.

Në relacion keni të parashikuar në mënyrë tabelare numrin e pozicioneve aktuale në gjykatat e apelit si më poshtë: Durrësi 13 gjyqtarë; Gjirokastra 6 gjyqtarë; Korça 6 gjyqtarë; Shkodra 10 gjyqtarë; Tirana 31 gjyqtarë; Vlora 12 gjyqtarë; Në tërësi numri i gjyqtarëve sipas dekretit në gjykatën e apelit sot është 78.

Në Raportin vlerësues të hartës së re gjyqësore është konkluduar pas një analize të kombinuar të të gjithë indikatorëve, faktorëve dhe objektivave të parashikuar nga neni 14 i ligjit nr. 98/2016 i ndryshuar, se përcaktimi i numrit 78 gjyqtarë, është aktualisht mekanizmi kryesor i ekuilibrimit të ngarkesës së gjykatës dhe vetë gjyqtarëve, duke siguruar një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në juridiksion apeli.

Programi kompjuterik i zhvilluar për të mbështetur analizën e hartës së re gjyqësore mundësoi vlerësimin e ngarkesës dhe të mesatares për gjyqtar në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Teknika e përdorur për të kryer analizën përfshin programimin matematikor ose më konkretisht, një variant të Analizës së Mbështjellëses së të Dhënave me kufizime në

ponderim. Me zbatimin e kësaj teknike, janë përllogaritur vlerat e ponderuara të çështjeve për secilin nga llojet e mëposhtme të çështjeve. Ponderimet e çështjes u përllogaritën si vlera mesatare të ponderimeve optimale të identifikuara nga një algoritëm përkatës.

Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës rezultoi 217 çështje për gjyqtar në gjykatat e apelit, përgjatë periudhës 2018–2020. Nëse në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm do të caktohen 78 gjyqtarë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të ishte e barabartë me mesataren në rang kombëtar, 217 çështje për gjyqtar (bëhet fjalë për çështje të reja).

Për të përcaktuar ngarkesën e punës treguesit janë vlerësuar duke kërkuar vendosjen e një ekuilibri midis shpërndarjes së ngarkesës së punës, shpërndarjes së gjyqtarëve ndërmjet gjykatave, si dhe numrit minimal të gjyqtarëve në çdo gjykatë.

Ngarkesa e gjykatës është përcaktuar jo vetëm nga numri total i çështjeve të reja, por edhe nga lloji i këtyre çështjeve, pra nëse çështjet e ndërlikuara dhe ato që marrin kohë përbëjnë përqindjen më të vogël apo atë më të madhe të çështjeve të një gjykate.

Vlerësimi i ngarkesës është përllogaritur duke u bazuar në specifikimet e përgjithshme të tilla si çështje më shumë komplekse janë konsideruar çështjet me palë kundërshtare, si dhe çështjet civile me palë kundërshtare, çështjet penale të themelit dhe çështjet e përgjithshme administrative të cilët kërkojnë më shumë burime njerëzore. Ndërsa si çështje më të lehta të cilat kërkojnë më pak burime janë konsideruar çështjet civile pa palë kundërshtare, çështjet penale të hetimit paraprak, të seancës paraprake apo kërkesat penale dhe kërkesat e tjera administrative.

Ngarkesat mesatare kombëtare për gjyqtar në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, me çështje e përdorura për qëllimet e vlerësimit kanë rezultuar nga 217 çështje të reja për gjyqtar, 48.5% kanë qenë çështje komplekse dhe 51.7% çështje të lehta.

Sa më sipër, propozohet që për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të ruhet numri aktual i gjyqtarëve të apelit, i cili është 78 gjyqtarë, pasi ky numër, në kushtet e një gjykate te vetme apeli, balancon ngarkesën e punës mes gjyqtarëve, bën të mundur specializimin e për pasojë rrit efiçencën.

Vlen të theksohet se numri i propozuar kërkon menaxhim të mirëmenduar jo vetëm afatshkurtër, por edhe sipas një studimi afatgjatë, të plotësimit të procedurave të lira të përhershme në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Konkretisht numri total i pozicioneve të kësaj gjykate është i barabartë me numrin 78 të gjyqtarëve. Në total, nëse nuk do të kemi rezultate te tjera nga procesi i rivlerësimit kalimtar, numri i pozicioneve të lira të përhershme në këtë gjykatë, në datë 01.02.2023, rezulton nga diferenca midis numrit 78 dhe shumatores së pozicioneve të zëna e atyre të lira të përkohshme.

Konkretisht, nëse gjendja nuk ndryshon, në datë 01.02.2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm do të kemi si më poshtë: 1) 25 pozicione efektive në detyrë (të cilat nuk kanë ndryshuar edhe sot); 2) 2 pozicione të lira të përkohshme për shkak të anëtarësisë në KLGJ; 3) 8 pozicione të shpallura për ngritje në detyrë, të papërfunduara (kemi pozicionet që i kemi konsideruar për efekt të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm); 4) Në relacion janë 18, por në fakt janë bërë 19 (sepse ka edhe një vendimmarrje së fundi nga KPA-ja), pozicione të lira të përkohshme për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, në pritje të vendimmarrjes së KPA-së, të cilat konsiderohen të zëna.

Në total numri i pozicioneve të lira të përhershme për të cilat Këshilli mund të vijojë procedurat e plotësimit të vakancave pas datës 01.02.2023, rezulton: 25 është në relacion, në fakt janë 26 pozicione.

Në plotësimin e këtyre pozicioneve Këshilli duhet të ketë në konsideratë nevojat e sistemit, ruajtjen e funksionalitetit të gjykatave, si dhe respektimin e së drejtës për t'u emëruar gjyqtar apeli për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pas përfundimit të mandatit të tyre në datë 17.06.2026, të drejtën e kthimit në apel për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, si dhe asaj Kushtetuese.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga një pikë, në të cilën parashikohet se numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është 78 gjyqtarë.

Në fund parashikohet hyrja në fuqi e tij, në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, nga kolegët nëse kemi ndonjë diskutim.

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga anëtarët pjesëmarrës në grupin e punës.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi projekt-aktin "Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", sipas propozimit të tre anëtarëve të grupit të punës për zbatimin e hartës gjyqësore.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore", i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që edhe ky është në kuadër të hartës së re gjyqësore. Relatore do të jetë zonja Shehu, anëtare e grupit të punës.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 118, pika 1, 147 pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja ‘d’ dhe ‘ë’, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika 3, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 61, pika 2, shkronja ‘ë’, në nenin 94, pika 4 dhe në nenin

97, pika 1, shkronja ‘c’, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është institucioni përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore normative.

Për zbatim të detyrimeve ligjore parashikuara në nenin 25, pika 3 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor detyrohet të miratojë rregullat e ndarjes së çështjeve me short të cilat duhet të përmbajnë domosdoshmërisht:

a) programin për organizimin e shortit, me qëllim që të disponojë karaktere dhe parametra të mjaftueshëm, të cilët sigurojnë standardet më të larta të transparencës dhe të kapaciteteve të gjurmimit;

b) mënyrën transparente të dokumentimit të përgatitjes së shortit;

c) afatet e organizimit të shortit dhe mënyrën e njoftimit paraprak të tij;

ç) kriteret për sigurimin e ndarjes së drejtë të çështjeve ndërmjet gjyqtarëve;

d) rastet dhe kriteret e rindarjes së çështjeve me short, kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara;

dh) kritere transparente dhe objektive për procedurën e përjashtimit të gjyqtarëve nga shorti për shkak të ngarkesës ose për shkak të angazhimit të gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor;

e) kritere transparente dhe objektive për ndarjen e çështjeve në rast mosfunksionimi të sistemit elektronik të çështjeve.

Aktualisht gjykatat realizojnë ndarjen e çështjeve me short përmes shortit elektronik, bazuar në rregullat e përgjithshme të kodeve të procedurave përkatëse si dhe mbi rregullat e përcaktuara me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”.

Ndonëse vendimi i KLD-së parashikon rregulla të përgjithshme të cilat nuk bien ndesh me rregullimet e kodeve të procedurave, nisur nga ndryshimet ligjore të pësuara në 2016 mbi kuadrin e plotë ligjor për organizimin e gjykatave dhe organeve qeverisëse të sistemit të drejtësisë, vlerësohet e nevojshme vendimmarrja për miratimin e rregullave të detajuara dhe të përditësuara për mënyrën e ndarjes së çështjeve me short.

Nisur edhe nga nevoja për parashikimin e rregullave të qarta të cilat duhet të zbatohen në momentin e implementimit të hartës së re gjyqësore dhe transferimit të dosjeve sipas kompetencave të reja tokësore, grupi i punës i ngritur për hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e hartës së re gjyqësore, paraqet për miratimin projektvendimin bashkëngjitur.

Rregullat e parashikuara në projekt-aktin e propozuar janë të natyrës së përgjithshme por edhe rregulla me natyrë teknike, kjo pasi mirëpërcaktimi i procesit të shortimit dhe rregullave të ndarjes së drejtë të çështjeve gjatë momentin të shortimit përbëjnë një nga elementët e caktimit të gjykatës me ligj.

Parashikimi i rregullave të qarta, të pa-ekuivokë dhe të mirëdetajuara, si dhe parashikimi në mënyrë të saktë dhe shteruese të rasteve përjashtimore do të mundësojnë caktimin e gjyqtarëve në mënyrë të njëjtë në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë duke unifikuar standardin dhe aplikimin e gjykatës së caktuar me ligj.

Në lidhje me përmbajtjen e projektvendimit, ai është organizuar në 5 kapituj të organizuar në rrjedhë logjike sipas praktikës së punës të realizuar në gjykata.

Kreu I " Objekti dhe parimet" parashikon objektin e vendimit të propozuar duke përfshirë gjithashtu fushën e veprimit të rregullave, ku përfshihen pa përjashtim të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë të të gjitha niveleve dhe juridiksioneve. Ndërsa në pikën e dytë të kapitullit janë përfshirë parimet kryesore nga të cilat duhet të udhëhiqet procesi i ndarjes së çështjeve me short ku përfshihen parimi i transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes dhe objektivitetit, parime të parashikuara në nenin 25 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kreu II "Ndarja e çështjes me short elektronik dhe kodi unik i organizimit të shortit" janë përcaktuar në aspektin teknik karakteristikat dhe kriteret e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, kritere të cilat plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 25, pika 3, shkronja 'a' të ligjit nr. 98/2016.

Është përcaktuar se zhvillimi i shortit do të kryhet nëpërmjet algoritmeve që vërtetojnë autenticitetin e shortit, integritetin e të dhënave, sigurinë dhe auditimin e tyre.

Ky algoritëm do të prodhojë një numër unik progresiv për çdo short që do realizohet nga gjykatat.

Parashikim në këtë kre i këtij përcaktimi, mundëson rritje të sigurisë së procesit të shortit, garanton auditim të automatizuar të procesit si dhe garanton integritetin e bllokut të informacionit të ruajtur.

Kreu III, "Procedurat dhe rregullat e shortit" paraqiten në mënyrë të detajuara rrugëtimi i çështjeve gjyqësore nga momenti i paraqitjes në gjykatë deri në kalimin e çështjes për shqyrtim gjyqtarit përkatës.

Në këtë kapitull ndahen qartë përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës, i cili ka detyrimin të planifikojë ditët e ndarjes së çështjeve me short, ditë të cilat janë parashikuar të realizohen çdo ditë pune. Në mënyrë përjashtimore është parashikuar shtyrja e shortimit për ditën vijuese të punës në rastet e pamundësisë objektive të realizimit të shortit elektronik, kjo për të limituar aplikimin e shortit manual vetëm në rastet e problemeve serioze të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve. Tjetër kompentencë e kryetarit të gjykatës është e drejta e caktimit të afatit të pezullimit të shortit ndërsa rastet janë parashikuar në mënyrë taksative në vendim. Pezullimi parashikohet vetëm në dy raste, për shkak të procesit të mbartjes së dosjeve dhe gjatë lejes vjetore në muajin gusht.

Më tej është parashikuar përgjegjësia e kancelarit të gjykatës i cili duhet të mbikëqyr përgatitjen e çështjeve të cilat do t'i nënshtrohen procesit të shortimit elektronik, procedurën e shortimit si dhe kalimin e çështjes tek gjyqtari relator.

Në këtë kapitull parashikohen gjithashtu aspektet e përgjithshme të publicitetit dhe transparencës së procesit të shortimit të tilla si realizimi në një sallë gjykimi, shfaqja në monitorët e gjykatës si dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të raportit të shortit, i cili është rezultati i krijuar përmes shortimit.

Së fundi në kapitull përcaktohen rregullat kryesore të shortimit, të rëndësishme për aplikimin uniform dhe të drejtë të ndarjes së çështjeve duke parashikuar ndarjen e barabartë të çështjeve për gjyqtarët. Për të shmangur interpretime të ndryshme të konceptit të barazisë, është përcaktuar përkufizimi i barazisë së ndarjes së çështjeve me short.

Parashikohet gjithashtu një parashikim specifik, ku parashikohet caktimi i gjyqtarit për çështjet penale me të mitur, konform nenit 27 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Kreu IV "Përjashtimi i çështjeve gjyqësore nga shorti". Listohen çështjet gjyqësore të cilat nuk i nënshtrohen procedurës së shortimit elektronik si dhe procedura e evidentimit të tyre dhe ndarjen e përgjegjësisë brenda gjykatës me qëllim llogaridhënien dhe transparencën e procesin për të evituar çdo paqartësi dhe aplikim jo të njëjtë. Çështjet që nuk i nënshtrohen shortit janë çështje për të cilat ligjet e posaçme dhe ligjet procedurale kanë parashikuar ndryshe, të tilla si çështjet urgjente të cilat i kalojnë gjyqtarëve të listës së miratuar nga kryetari i gjykatës, çështjet penale për të cilat është pranuar gjykimi i shkurtuar të cilat gjykohen nga gjyqtari i seancës paraprake sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, si dhe çështjet e caktuara me short, për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar, të cilat i kalojnë të njëjtit trup gjykues.

Kreu V parashikohen rastet e përjashtimit të gjyqtarit nga shorti.

Ndërsa në kapitullin e fundit, për zbatim të nenit 25, pika 3 shkronja 'e' të ligjit nr. 98/2016 janë parashikuar rastet e ndarjes së çështjeve përmes shortit manual. Për të evituar abuzime me shortin manual të çështjeve në këtë kapitull janë parashikuar disa mekanizma si aplikimi i shortit manual vetëm në rastet e mosfunksionimit të sistemit elektronik për më shumë se dy ditë, dhe vetëm kur ky mosfunksionim është i dokumentuar. Një tjetër mekanizëm është realizimi i shortit në prezencë të gjyqtarëve të gjykatës të cilët mund të verifikojnë personalisht trajtimin e tyre të barabartë në caktimin e çështjeve. Në çdo rast procedura e shortit manual do t'i nënshtrohet parimit të publicitetit dhe për aq sa është e mundur parimeve nga të cilat udhëhiqet shorti elektronik i ndarjes së çështjeve.

Lidhur me strukturën e projektvendimit të paraqitur për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare, ai përbëhet nga VI –të Kre.

Kreu I, titullohet: Objekti dhe parimet.

Kreu II, titullohet: Ndarja e çështjes me short elektronik dhe kodi unik i organizimit të shortit.

Kreu III, titullohet: Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short.

Kreu IV, titullohet: Përjashtimi i çështjeve gjyqësore nga shorti.

Kreu V, titullohet: Përjashtimi i gjyqtarit nga shorti.

Kreu VI, titullohet: Ndarja e çështjeve me short manual.

Në fund të projektvendimit parashikohet hyrja në fuqi e këtij vendimi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Ky është edhe projektvendimi i cili i paraqitet sot për miratim mbledhjes plenare.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Shehu!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim për sa kanë propozuar anëtarët e grupit të punës.

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore" sipas propozimit të ardhur nga grupi i punës së zbatimit të hartës gjyqësore.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore" i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore" i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore. Për më shumë detaje, fjalën do ia jap zotit Rusi.

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Relacion “Mbi projektvendimin "Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore””.

Referuar detyrimit ligjor për nxjerrjen e aktit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efiçencës, administrimit efektiv të gjykatave, dhe sigurimit të mirëfunksionimit të tyre në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, ka filluar procesin për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, por edhe në gjykatat e rretheve gjyqësore. Akti i paraqitur për miratim synon të përmbushë detyrimet kushtetuese e ligjore.

- nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

- parashikimet e nenit 90, shkronja “g” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, sipas të cilit Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata;

- parashikime të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- parashikime të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;

- ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Natyra e aktit dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor ekzistues - Akti i paraqitur për miratim synon të përmbushë objektivin strategjik për menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe në gjykatat e rretheve gjyqësore, të cilat ushtrojnë veprimtari në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Ky objektiv merr rëndësi të veçantë në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, pasi gjykatat e riorganizuara do të kenë kapacitetet e nevojshme profesionale për të vijuar ofrimin e shërbimeve në kohën e duhur dhe me cilësi.

Rishpërndarja dhe miratimi i numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, apo edhe i gjykatave të tjera, lidhet ngushtë me administrimin efektiv të burimeve njerëzore.

Konsultimi i aktit - Rishpërndarja është një produkt i dakordësuar në mbledhje nga anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës. Në këtë relacion shpjegues parashtrohen dhe argumentohen zgjidhjet e propozuara për zbatimin efektiv të hartës së re gjyqësore.

Komente të përgjithshme mbi aktin - Akti i propozuar për miratim ka për qëllim plotësimin e parashikimeve ligjore që autorizojnë KLGJ-në për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës, duke zbatuar për aq sa është e mundur edhe rregullime konkrete të ligjit "Për nëpunësin civil", si dhe praktikat më të mira në këtë drejtim, me qëllim vijimin e funksionimit dhe përmbushjen e objektivave nga data 1 shkurt 2023, si dhe të gjykatave të tjera në të cilat për shkak të detyrimeve ligjore do të pozicionohen nëpunës civilë gjyqësorë apo punonjës të tjerë administrative të cilët për shkaqe ligjore nuk mund të transferohen në mënyrë të përhershme pranë gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Shpjegim i detajuar i përmbajtjes së aktit - Akti ka për qëllim, miratimin e rishpërndarjes së numrit të pozicioneve të punës, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, pas shpërndarjes së numrit të pozicioneve të gjykatave të apeleve ekzistuese.

Në respektim dhe zbatim të vendimit të KLGJ-së nr. 505, datë 21.11.2022 "Për fillimin e funksionimit të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm", të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat përcaktojnë numrin e pozicioneve për funksionimin e strukturave (drejtori/sektorë) në institucione, si dhe mbështetur në numrin faktik të punonjësve/nëpunësve pranë gjykatave të apeleve, është draftuar struktura organizative dhe organigrama e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku është përcaktuar me total 245 pozicione, të detajuara edhe në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur aktit: konkretisht - 78 trupa gjyqësore; - 32 ndihmës ligjorë; - 116 nëpunës civilë gjyqësorë; - 19 punonjës të tjerë.

Grupi Ndërinstitucional i Punës, duke mbajtur në konsideratë, qëllimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sistemim të punonjësve, duke ruajtur numrin total të sistemit

gjyqësor 1595 në total (408 gjyqtarë dhe 1187 administratë gjyqësore), duke vlerësuar opinionet e dhëna nga kancelarët e gjykatave të apeleve, në mbledhjen e zhvilluar pranë ambienteve të KLGJ-së, përcjellë dhe në rrugë elektronike, por edhe në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil publik, për aq sa lejohet dhe mundësohet, ka mundësuar sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur aktit, shpërndarjen e 29 pozicioneve të punës si dhe detajimin e numrit të pozicioneve/punonjësve të gjykatave aktuale të apeleve në gjykata të rretheve gjyqësore.

Aktualisht në gjykatat e apelit janë 274 pozicione duke përfshirë në këtë numër edhe numrin 78 të gjyqtarëve, ndërsa në raport edhe të ristrukturimit dhe në raport të krimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm numri do të jetë 245 pozicione duke përfshirë në të edhe numrin 78 të gjyqtarëve. Numri 29 i pozicioneve në strukturë do të pozicionohen duke marrë në konsideratë edhe vakancat që kanë gjykatat e tjera të rretheve gjyqësore dhe është menduar që këto 29 pozicione të shpërndahen në:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër: 3 pozicione;
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër: 8 pozicione;
3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë: 15 pozicione;
4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë: 3 pozicione.

Relacioni shoqërohet edhe me tabelat përkatëse, duke dhënë një pasqyrë mbi aktualitetin e numrit të punonjësve ne gjykatat aktuale të apelit dhe ato çfarë do të jenë në një moment të dytë në lidhje me gjykatat e rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm.

Akti përbëhet nga tre pika. Në pikën e parë: 1. Të miratojë rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të miratojë rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Pezullimin e të gjitha procedurave të rekrutimit, për plotësimin e vendeve vakante për të gjithë kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me çfarë është parashikuar?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga grupi i punës.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në gjykatat e rretheve gjyqësore. Gjithashtu një nga gjërat që Këshilli ka vendosur në këtë vendimmarrje është edhe pezullimi i të gjitha procedurave të rekrutimit, për plotësimin e vendeve vakante për të gjithë kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit për shkak të zbatimit të hartës së re gjyqësore. Patjetër që ky vendim do të hyjë në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër, i cili ka të bëjë me miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit Kryetare!

Relacion "Mbi projektvendimin "Për Miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm""

Detyrimi ligjor për nxjerrjen e aktit - Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efiçencës, administrimit efektiv të gjykatave, dhe sigurimit të mirëfunksionimit të tyre në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, ka filluar procesin për miratimin e rregullave më të detajuara për funksionimin e brendshëm të gjykatave të riorganizuara. Kjo nismë normative bazohet në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja "ë" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 61 pika 2, shkronja "ë", nenit 89, 94 pikat 1 e 3 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe nenet 41 dhe vijues të ligjit nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Për shkak të rëndësisë dhe pozicionit të posaçëm që ka Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në sistemin gjyqësor, si dhe nisur nga domosdoshmëria për ta bërë atë funksionale dhe efektive nga data 1 shkurt 2023, i paraqitet sot për miratim mbledhjes plenare një projektvendim mbi rregullat standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të punonjësve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Miratimi i këtij projektvendimi lidhet ngushtësisht me ngritjen dhe fillimin e punës të Komisioneve të Ristrukturimit, të ngarkuar me vlerësimin dhe e mundësive për sistemimin e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë në strukturën e gjykatës së riorganizuar.

Natyra e aktit dhe harmonizimi i tij me kuadrin ligjor ekzistues - Përgatitja e këtij projektvendimi përmbush detyrimin ligjor që buron nga parashikimet e neneve 89 shkronja "c" dhe 94, pikat 1 dhe 3 të ligjit "Për qeverisjen", i cili përcakton shprehimisht se Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla standarde për funksionimin e brendshëm të gjykatave. Këto rregulla standarde përmbajnë norma në lidhje me strukturën e

gjykatave, efiçencën dhe cilësinë e drejtësisë që japin gjykatat. Rregullat standarde për strukturën përmbajnë të paktën rregullimet e mëposhtme:

a) Organigrama standarde për gjykatat e të gjitha niveleve;

b) Përshkrime standarde të detyrave dhe përgjegjësive për secilin pozicion të punonjësve të gjykatave;

Projektvendimi objekt shqyrtimi parashikon vetëm rregullat standarde të strukturës, organigramës dhe përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësive për kategoritë e punonjësve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm sipas autorizimit të ligjit për këtë qëllim. Në këtë kontekst është mbajtur parasysh jo vetëm ligji "Për qeverisjen", por edhe ligji nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", i cili në Kreun IV "Funksionimi i administrimit gjyqësor", në Seksionin II të tij, nenet 41-49, parashikon rregulla standarde në lidhje me administrimin e brendshëm gjyqësor.

Projektvendimi ka si pjesë të tij integrale tekstin kryesor ku parashikohen rregullat standarde të brendshme dhe 2 Anekse: Aneksi 1 përmban organigramën standarde sipas strukturave bazë që parashikon ligji "Për pushtetin gjyqësor" si dhe ky projektvendim; Aneksi 2 përmban përshkrimet e punës për secilin pozicion, ku përfshihen roli, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo pozicion, duke filluar nga nëpunësi më i larë civil gjyqësor, që është kancelari deri tek shërbimet mbështetëse.

Përputhshmëria e aktit me standardet ndërkombëtare – Hartimi i këtij projektvendimi ka ardhur si rezultat i një pune intensive të Grupit Ndërinstitucional të Punës, i cili është mbështetur edhe në projektet e partnerëve ndërkombëtarë.

Konsultimi i aktit – Rregullat standarde së bashku me organigramën dhe përshkrimet e punës, janë një produkt i dakordësuar në mbledhje nga të gjithë anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës në lidhje me hartën. Në këtë relacion shpjegues parashtrohen dhe argumentohen zgjidhjet e propozuara për zbatimin efektiv të hartës.

Komente të përgjithshme mbi aktin – Akti i konceptuar si një tërësi rregullash (rregullore), ka për qëllim plotësimin e bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e strukturës së brendshme të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të bërë të mundur funksionimin sa më efektiv, profesional dhe transparent të veprimtarisë së kësaj gjykate nga data 1 shkurt 2023.

Rregullat e organizimit të brendshëm garantojnë parime, si ai i hierarkisë, llogaridhënies, ligjshmërisë, efektivitetit, paanshmërisë, transparencës, aksesit në drejtësi, si dhe bashkëpunimit institucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke respektuar, në të njëjtën, kohë pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarëve të saj.

Akti nënligjor, në detajimin e strukturës organizative të gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm udhëhiqet nga kërkesat e parashikimeve ligjore në lidhje me organet vendimmarrëse dhe ndërveprimin midis tyre, si dhe shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse, strukturat përkatëse të përfshira në secilin shërbim, si dhe funksionet e përgjegjësitë e tyre. Risia e këtij akti nënligjor ka të bëjë me përfshirjen në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të Zyrave të Shërbimit, që synojnë të garantojnë vijimësinë e marrjes së shërbimeve administrative gjyqësore në të njëjtin vend dhe akses të barabartë në gjykatë.

Shpjegim i detajuar i përmbajtjes së aktit – Rregullat e përgjithshme standarde për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm gjenden të ndara në 5 (pesë) krerë, të cilët në mënyrë të përmbledhur përmbajnë rregullime si vijon:

Kreu I i projektvendimit, titulluar “Dispozita të përgjithshme”, përfshin 3 nene të cilat përcaktojnë objektin, qëllimin dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Konkretisht, qëllimi i projektvendimit është plotësimi i bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e strukturës së brendshme të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të bërë të mundur funksionimin sa më efektiv, profesional dhe transparent të veprimtarisë së kësaj gjykate. Parimet e organizimit dhe funksionimit të kësaj gjykate janë: hierarkia e sistemit gjyqësor, llogaridhënia, ligjshmëria, efektiviteti, paanshmëria, transparenca, aksesi në drejtësi, si dhe bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke respektuar, në të njëjtën kohë pavarësinë dhe paanësinë e gjyqtarëve të saj.

Kreu II i projektvendimit, titulluar “Struktura organizative dhe organet vendimmarrëse të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, përfshin 2 nene, të cilat listojnë respektivisht të gjitha njësitë përbërëse të Gjykatës dhe organet vendimmarrëse, pavarësisht rolit që ato kanë, ose funksionit që kryejnë, detajime këto të cilat rregullohen në dispozitat në vijim. Neni 4 liston si vijon:

a) Kryetari;

b) Trupa gjyqësore;

c) Kancelari;

ç) Njësia e Shërbimit Ligjor;

d) Kryesekretari;

e) Sekretaria Gjyqësore;

f) Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;

g) Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve;

h) Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë;

i) Sektori i Protokollit dhe Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit.

Ndërsa më tej, në nenin 5 janë parashikuar vetëm organet vendimmarrëse të gjykatës, duke përcaktuar funksionin e tyre kryesor. Organet vendimmarrëse për mbarëvajtjen gjyqësore dhe administrative të Gjykatës së Lartë janë: a) Kryetari; b) Këshilli i Gjykatës; c) Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve; ç) Kancelari. Duke qenë se kompetencat e këtyre organeve janë të parashikuara në ligj thuajse në mënyrë shteruese, është vlerësuar që në projektvendim të mos pasqyrohen, me qëllim shmangien e përsëritjes së dispozitave ligjore, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha subjektet.

Dispozitat në vijim janë të organizuara në përputhje me parashikimet e nenit 41 të ligjit "Për pushtetin gjyqësor", i cili përcakton 3 shtyllat e shërbimeve në gjykata: shërbime gjyqësore, shërbime administrative dhe shërbime mbështetëse. Secili prej këtyre shërbimeve është rregulluar në një kre të veçantë.

Kreu III i projektvendimit, titulluar "Shërbimet gjyqësore të Gjykatës", përbëhet nga 4 nene, të cilat detajojnë strukturat që kryejnë shërbime gjyqësore. Këtu përfshihen: a) Njësia e Shërbimit Ligjor; b) Kryesekretari; c) Sekretari gjyqësor. Edhe këto struktura janë të parashikuara në ligj me kompetenca konkrete, prandaj projektvendim liston funksionet kryesore, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat në përshkrimin e punës sipas Aneksit 2.

Në lidhje me Njësinë e Shërbimit Ligjor, projektvendimi përcakton rregulla orientuese për caktimin e ndihmësve ligjorë pranë seksioneve e gjyqtarëve përkatës, duke listuar kriteret ligjore si përvoja profesionale dhe specializimi i ndihmësit ligjor. Megjithatë akti nënligjor sjell në vëmendje se është rregullorja e brendshme e gjykatës ajo që do të parashikojë rregulla më të hollësishme për organizimin, funksionimin si dhe ndërveprimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor me strukturat e tjera të gjykatës.

Kreu IV i projektvendimit, titulluar "Shërbimet administrative dhe mbështetëse dhe funksionet e tyre", përmban 5 nene të cilat detajojnë strukturat që kryejnë vetëm shërbime administrative dhe mbështetëse sipas ligjit.

Neni 10 liston strukturat që ofrojnë shërbimet administrative, si vijon:

a) Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;

b) Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve;

c) Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, e Median;

ç) Sektori i Protokollit dhe Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit.

Ky nen bën dallimin midis strukturave administrative dhe atyre mbështetëse, duke evidentuar qartë edhe statusin e nëpunësve që ushtrojnë respektivisht funksione administrative apo mbështetëse, organet e emërtesës apo të shkarkimit të tyre. Strukturat e shërbimeve administrative janë përgjegjëse për mirëfunksionimin e veprimtarive administrative të gjykatës, kurse shërbimet mbështetëse sigurojnë ruajtjen, kujdesin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të gjykatës, si dhe garantimin e ushtrimit të funksioneve gjyqësore dhe administrative.

Për efekt të organizimit më efektiv të veprimtarisë së brendshme të gjykatës strukturat e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë ideuar si kombinime midis shërbimeve administrative dhe atyre mbështetëse. Ndërsa shërbimet administrative realizohen nga nëpunës civilë gjyqësorë, vendimi qartëson se sipas rastit shërbimet mbështetëse mund të ushtrohen nga nëpunës civilë gjyqësorë, që kryejnë detyrat sipas përshkrimeve të punës bashkëlidhur kësaj rregullore dhe atyre të miratuara nga Këshilli i Gjykatës, por edhe nga punonjës të tjerë gjyqësorë që emërohen dhe shkarkohen nga

kancelari dhe marrëdhëniet e punës së tyre rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 11 parashikon Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Vendimi propozon organizimin e kësaj strukture në formën e Drejtorisë, kërkesë e cila buron edhe nga legjislacioni i posaçëm financiar. Ndërkohë detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve civilë gjyqësorë – specialist buxheti dhe specialist finance gjenden të detajuara në përshkrimet e punës.

Neni 12 parashikon Sektorin e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse, strukturë e cila kombinon 3 shërbime: 2 të natyrës administrative (burimet njerëzore dhe prokurimet) dhe 1 të natyrës mbështetëse. Edhe në këtë rast dispozita plotësohet me përshkrimet e punës së specialistëve të këtij Sektori.

Neni 13 parashikon Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, strukturë e cila kombinon 2 shërbime të natyrës administrative, ato që lidhen me Teknologjinë e Informacionit e Statistikat dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë.

Neni 14 parashikon Sektorin e Protokollit, Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit. Përveç shërbimeve të Protokollit dhe Arkivës, risia e këtij neni është parashikimi i zyrave të shërbimeve që ngrihen dhe funksionojnë në Durrës, Korçë, Gjirokastër, Vlorë dhe Shkodër për të ofruar shërbime administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.

Zyrat e Shërbimit janë pjesë e strukturës organizative të gjykatës së krijuar nga bashkimi i gjykatave. Ato do të ushtrojnë veprimtarinë pranë godinave ekzistuese të gjykatave, me numrin e nevojshëm të punonjësve për dhënien e shërbimit dhe për ruajtjen e arkivave të gjykatave që bashkohen. Në këtë mënyrë nuk do të jetë e nevojshme lëvizja e arkivit të gjykatës si dhe krijohet mundësia e punësimit të një pjese të stafit administrativ të gjykatës që do të bashkohet me një tjetër. Këto zyra krijojnë më shumë fleksibilitet dhe lehtësi në aksesin në gjykatë të përdoruesve të gjykatave, po edhe për gjykatën kryesore në marrjen e kërkesave apo dokumenteve si dhe bashkimin e tyre me pjesën tjetër të kërkesave që do të shqyrtohen nga gjykata. Po ashtu, krijimi i zyrave nuk kërkon ndërhyrje të mëtejshme në ligjet procedurale përkatëse.

Çdo zyrë shërbimi përbëhet nga të paktën 2 (dy) nëpunës civilë gjyqësorë që ushtrojnë funksionet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje. Nëpunësit civilë gjyqësorë që ushtrojnë funksionet pranë zyrave të shërbimeve në rrethe, marrin në dorëzim dhe përcjellin pa vonesë për trajtim në strukturën qendrore të shërbimeve gjyqësore ose administrative të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, çdo kërkesë ose dokument që paraqitet nga palët në një proces gjyqësor, përfaqësuesit ligjorë, përdoruesit e tjerë të gjykatës si dhe çdo subjekt tjetër i interesuar. Kancelari mbikëqyr funksionimin e zyrave të shërbimeve dhe siguron koordinimin me shërbimet e tjera të gjykatës.

Funksionet e zyrave të shërbimit plotësohen edhe nga neni 15, dispozitë kalimtare e cila synon të normojë tërësinë e veprimeve që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore të çështjeve të përfunduara deri në datën 31 janar 2023, duke i ngarkuar punonjësve të ZSH-ve kryerjen e të gjitha detyrat e sekretarit gjyqësor, të tilla si:

a) komunikimin e vendimeve gjyqësore palëve ndërgjyqëse;

b) komunikimin e rekursit/kundër-rekursit palëve ndërgjyqëse në çështjet civile dhe përcjelljen e dosjes gjyqësore me aktet e plota për vlerësim nga gjyqtari relator në lidhje me lejimin e rekursit;

c) komunikimin e rekursit palëve ndërgjyqëse në çështjet penale dhe përcjelljen e dosjes gjyqësore me aktet e plota për në Gjykatën e Lartë;

ç) përcjelljen për në gjykatat e rretheve gjyqësore përkatëse, të dosjeve gjyqësore për çështjet e përfunduara për të cilat nuk është ushtruar rekurs;

d) kryerjen e veprimeve lidhur me arkivimin e dosjeve të çështjeve të juridiksionit fillestar, për të cilat nuk është ushtruar rekurs;

e) kryerjen e detyrave të tjera sipas nevojës dhe delegimit.

Së fundi, Kreu V përcakton organet dhe tërësinë e veprimeve duhet të përmbushen për zbatimin e këtij vendimi në dy periudha kohore, konkretisht nga hyrja në fuqi e tij deri në datën 31 janar 2023, si dhe nga data 1 shkurt 2023 e në vijim.

Konkretisht, brenda 2 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Këshilli i Gjykatës së Apelit miraton strukturën, organikën, si dhe përshkrimet e hollësishme të punës, duke i përshtatur me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës. Miratimi i sa më sipër

lidhet ngushtë me ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit, që është objekt rregullimi me një akt të veçantë, i cili detajon tërësinë e rregullave dhe procedurave që duhet të zhvillohen e përfundohen deri në datën 31 janar 2023. Këto procedura lidhen ekskluzivisht me transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë gjyqësorë, dhe jo me plotësimin e pozicioneve të reja të nivelit drejtor apo shef sektori. Verifikimi i pozicioneve vakante dhe vijimi i procedurave të rekrutimit për pozicionet drejtor apo shef sektori, do të bëhet nga Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pas ristrukturimit dhe përfundimit të procesit të transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë.

Aneksi 1 pasqyron organigramën standarde të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm bashkë me detajimin e pozicioneve në strukturë.

Aneksi 2 përmban përshkrimet standarde të punës, detyrave dhe përgjegjësive për secilën kategori të punonjësve të gjykatave. Në çdo përshkrim gjenden sipas një strukture të mirëorganizuar: emërtesa e pozicionit dhe njësia organizative; qëllimi i pozicionit; detyra kryesore; përgjegjësitë kryesore në drejtim të planifikimit, menaxhimit, detyrave teknike apo bashkëpunimit dhe përfaqësimit institucional; zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; mjedisit menaxherial; mbikëqyrjes; stafit në varësi; kushteve të punës e kritereve të veçanta të arsimit, përvojës profesionale e kritereve të tjera ligjore. Vlen të theksohet se për çdo pozicion nëpunësi civil gjyqësor janë përshkruar veprimtaritë që ata kryejnë rregullisht, sipas kërkesave të Ligjit 98/2016.

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Këshilli i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nga data 1 shkurt 2023 Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për sa më sipër në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet, miratimi i "Rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të punonjësve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm", sipas tekstit dhe Anekseve 1 dhe 2 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, keni ndonjë diskutim lidhur me sa u propozua nga anëtarët e grupit të punës?

Nëse jo, atëherë kalojmë në miratimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas tekstit bashkëlidhur dhe anekseve të këtij vendimi, dhe sipas propozimit të sjellë nga anëtarët.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit" i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit" i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj.Brikena Ukperaj dhe znj.Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti i fundit që ka të bëjë në kuadër të akteve për zbatimin e hartës gjyqësore dhe që ka të bëjë me krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit. Për më shumë detaje, fjalën ia jap prapë zotit Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Relacion "Mbi projektvendimin "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit"".

Duke qenë se edhe pjesa hyrëse e këtij relacioni të tretë ka të njëjtat qëllime, objektiva, referenca ligjore, mendoj të kaloj tek komentet e përgjithshme mbi natyrën e aktit që mos kalojmë në përsëritje.

Akti i propozuar për miratim ka për qëllim detajimin dhe plotësimin e parashikimeve ligjore që autorizojnë KLGJ-në për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, duke zbatuar për aq sa është e mundur edhe rregullime konkrete të ligjit "Për shërbimin civil", si dhe praktikat më të mira në këtë drejtim. Akti ka për qëllim rregullimin e procedurës së ndërveprimit midis Komisionit të Ristrukturimit, Këshillave të Gjykatave aktuale/ KLGJ dhe nëpunësve civilë gjyqësorë/punonjësve të tjerë. Procesi është konceptuar si faza përgatitore, e cila mundëson që në 1 shkurt 2023 administrata e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të jetë e organizuar dhe e gatshme të vijojë ofrimin e shërbimeve gjyqësore, administrative dhe mbështetëse. Ky objektiv do të synohet edhe për gjykatat e rretheve gjyqësore apo ato administrative.

Komisioni i Ristrukturimit është një strukturë e përkohshme, përbërja e të cilit mundëson të sigurojë një proces legjitim dhe të balancuar, ku objektivi kryesor mbetet krijimi i një administrate me aftësitë e nevojshme profesionale dhe integritet të lartë. Funksioni kryesor i Komisionit të Ristrukturimit është verifikimi i kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë gjyqësorë të konfirmuar në detyrë apo në periudhë prove, si dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë, që i nënshtrohen ristrukturimit për shkak riorganizimi, me qëllim transferimin e tyre të përhershëm, në kohën e duhur dhe me efektivitet, në strukturën e gjykatës pritëse. Procedurat e përcaktuara në aktin e propozuar janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha gjykatat që i nënshtrohen riorganizmit të kompetencave territoriale. Ky proces do të zbatohet fillimisht në gjykatat e apeleve, për të vijuar me gjykatat e rretheve dhe përfunduar me gjykatat administrative të shkallës së parë.

Shpjegime mbi aktin – Akti është organizuar në 3 Krerë dhe përbëhet nga 9 nene.

Kreu I, me titull "Dispozita të Përgjithshme", përcakton qëllimin e aktit dhe fushën e tij të zbatimit. Akti synon të përmbushë 2 qëllime kryesore:

Së pari, të përcaktojë rregulla të detajuara për krijimin dhe funksionimin e

Komisioneve të Ristrukturimit që ngrihen në kuadër të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave.

Së dyti, të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë që duhet të përmbushë respektivisht:

(i) Komisioni i Ristrukturimit për verifikimit të kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë gjyqësorë të konfirmuar në detyrë apo në periudhë prove, si dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë, që i nënshtrohen ristrukturimit për shkak riorganizimi, me qëllim transferimin e tyre të përhershëm, në kohën e duhur dhe me efektivitet, në strukturën e gjykatës pritëse.

(ii) Këshilli aktual i gjykatës pritëse për transferimin e përhershëm në pozicion të një nëpunësi civil gjyqësor apo punonjësi tjetër të gjykatës;

(iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor si autoriteti përgjegjës për Kancelarët;

(iv) Çdo nëpunës civil gjyqësor, apo punonjës tjetër i gjykatës, me përjashtim të ndihmësve ligjorë. Për këtë kategori, transferimi është i detyrueshëm dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

Në lidhje me fushën e zbatimit, akti në fjalë gjen zbatim për të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë të konfirmuar në detyrë apo në periudhë prove, si dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë, që i nënshtrohen ristrukturimit të gjykatave për shkak riorganizimi. Pjesë e procesit të ristrukturimit janë edhe kancelarët në detyrë, të cilët do të sistemohen përkohësisht në pozicione, kjo për faktin se sistemimi i përhershëm lidhet me kalimin me sukses të provimit në Shkollën e Magjistraturës.

Përjashtimisht, referuar rregullimeve të aktit kuadër për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit:

(i) Administrata gjyqësore e Gjykatës së Apelit Tiranë, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, të cilët vijojnë të ushtrojnë veprimtarinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.

(ii) Ndihmësi ligjor me emërim përfundimtar në gjykatat e apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të

riorganizimit gjyqësor, i cili transferohet në mënyrë të përhershme në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Kreu II, titullohet "Krijimi, përbërja dhe funksionimi i Komisioneve të Ristrukturimit", dhe përbëhet nga nenet 2 dhe 3, të cilët përcaktojnë respektivisht rregulla për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, përbërjen e tyre dhe vendin e funksionimit.

Neni 2 përcakton KLGJ si autoritetin përgjegjës për krijimin e Komisioneve të Ristrukturimit. Në aspektin kohor, Komisionet i Ristrukturimit ngrihen jo më vonë se dy ditë pas hyrjes në fuqi të aktit për miratimin e strukturës organizative, nga Këshillat aktualë të gjykatave pritëse. Afati i ngushtë kohor kërkon koordinim efektiv nga ana e çdo gjykate, veçanërisht të atyre të rretheve ku numri i Komisioneve të Ristrukturimit që do të ngrihen është më i madh krahasimisht me gjykatat e niveleve të tjera.

Veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit mbështetet nga Sekretaria Teknike, funksionet e së cilës ushtrohen nga njësia e burimeve njerëzore të gjykatës ku kryhen veprimtarinë Komisioni i Ristrukturimit.

Mbledhja e parë e Komisionit të Ristrukturimit thirret nga përfaqësuesi i KLGJ brenda dy ditëve nga krijimi i tyre. Roli drejtues dhe funksionet e përfaqësuesit të KLGJ burojnë shprehimisht nga ligji. Në aspektin praktik, kjo zgjidhje garanton edhe më shumë qëndrueshmërinë dhe njëtrajtshmërinë e vendimmarrjes.

Neni 3 rregullon përbërjen dhe funksionet e Komisioneve të Ristrukturimit, të cilët siç u theksua më sipër shqyrtojnë mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të gjykatave që i nënshtrohen riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse, apo edhe në pozicione të së njëjtës kategori, në gjykata të tjera. Procesi i riorganizimit të gjykatave kërkon para së gjithash që të ruhet kapaciteti profesional aktual i gjykatave, si e vetmja mënyrë për të siguruar ofrimin e shërbimeve cilësore. Për këtë arsye, është parë e udhës që gjatë procesit të ristrukturimit të vlerësohet mundësia e sistemimit në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo pritëse, i atyre punonjësve të cilët për shkaqe të përcaktuara nga ligji si p.sh. shkaqe shëndetësore të provuara me dokument mjekësor apo kur pozicioni i propozuar gjendet mbi 45 km larg vendit të banimit, nuk mund të transferohen në një gjykatë tjetër. KLGJ është duke marrë

të gjitha masat për të koordinuar procesin me qëllim që çdo nëpunës civil gjyqësor ashtu dhe punonjës tjetër të sistemohet në një pozicion pune.

Në lidhje me përbërjen e Komisioneve të Ristrukturimit, janë kryetarët dhe kancelarët e gjykatave që i nënshtrohen riorganizimit të kompetencave tokësore si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor që drejton Komisionit të Ristrukturimit. Nisur nga situata aktuale ku një numër gjykatash drejtohen nga zëvendëskryetarët, akti ka parashikuar edhe rastin përjashtimor që në mungesë të kryetarit ose të kancelarit, anëtarë të Komisionit të Ristrukturimit janë zëvendëskryetarët dhe nëpunësit që ushtrojnë detyrat e kancelarit.

Gjithashtu është përcaktuar edhe vendi në të cilit do të ushtrohen funksionet nga ana e Komisioneve të Ristrukturimit.

KREU III, titullohet "Verifikimi i kritereve dhe njoftimi i vendimit propozues të transferimit të përhershëm" dhe përbëhet nga 6 nene, të cilat detajojnë fazat e procesit të ristrukturimit dhe ndërveprimin midis Këshillit aktual të gjykatës pritëse dhe nëpunësve civilë gjyqësorë apo punonjësve të tjerë.

Procesi është hartuar duke marrë në konsideratë parimet e transparencës, bashkëpunimit dhe të drejtës së punonjësve për të shprehur lirshëm dhe pa presion mendimin mbi vendimin propozues të tyre.

Neni 4 detajon fillimin e procesit, duke përcaktuar kancelarin apo përfaqësuesin e KLGJ për njoftimin e nëpunësve për fillimin e procesit të ristrukturimit, kurse neni 5 përcakton afatin kohor brenda të cilit kancelari vë në dispozicion të Komisionit të Ristrukturimit dokumentacionin e të nevojshëm për vlerësimin e nëpunësve/punonjësve, që përfshin (i) Përshkrimet e punës së pozicioneve dhe kriteret specifike; (ii) Kopje të dosjes personale, në format fizik të nëpunësve të gjykatave, në pritje për transferim të përhershëm; (iii) Vërtetimin e vendbanimit.

Neni 6 rregullon kriteret mbi të cilat Komisioni i Ristrukturimit bazon vlerësimin, duke renditur si të tillë:

(i) Arsimimin e nëpunësit/punonjësve;

(ii) Përvojën profesionale në tërësi, përfshi vjetërsinë e shërbimit në sistemin

gjyqësor, pozicionin aktual në gjykatë në momentin e riorganizimit, si dhe pozicione të tjera.

Çdo Komision Ristrukturimi ka në dispozicion 15 ditë nga hyrja në fuqi e vendimit për krijimin e tij, që të përfundojë procesin e vlerësimit dhe të miratojë vendimin propozues për transferimin e përhershëm të të gjithë nëpunësve të gjykatës.

Në aspektin e metodologjisë së vlerësimit, Komisionet e Ristrukturimit bazohen në këto elementë:

a) Krahasimin e strukturës së gjykatës pritëse me strukturën ekzistuese dhe evidentimin e shërbimeve të reja organizative që krijohen, suprimohen apo që ndryshojnë në strukturën e gjykatës pritëse;

b) Verifikimin e përshkrimeve të punës;

c) Verifikimin e dosjeve personale të nëpunësve civilë gjyqësorë;

(i) përvojën profesionale dhe arsimimin;

(ii) largësinë e vendbanimit më shumë së 45 km nga institucioni;

ç) dokumentin përkatës të nëpunësit civil gjyqësor me probleme shëndetësore të vërtetuara me raportin përkatës mjekësor.

Në këtë rast akti bën referim në rregullime konkrete të ligjit "Për nëpunësin civil", dhe për këtë arsye e ngarkon Komisionin të trajtojë me prioritet nëpunësit me probleme shëndetësore të vërtetuara me raport mjekësor, si dhe ata që kanë vendbanimin më shumë se 45 km nga vendi i punës.

Në rastet e punonjësve të tjerë të gjykatave, vlerësimi i Komisionit bazohet në përvojën profesionale në tërësi, në sistemin gjyqësor si dhe mundësitë e sistemimit në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse apo sistemim e tij në një gjykatë tjetër.

Neni 7 rregullon procesin e dërgimit të vendimit propozues për transferimin e përhershëm të nëpunësit civilë gjyqësorë Këshillit aktuale të gjykatës pritëse. Për kancelarët, vendimi propozues i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor. Vendimi propozues identifikon pozicionin në strukturën e gjykatës pritëse, ose sipas rastit në gjykata të tjera, apo përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil gjyqësor.

Akti ka parashikuar rregulla të detajuara mbi vendimmarrjen e Komisionit të

Ristrukturimit, ku vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, të cilët duhet të jenë të gjithë detyrimisht të pranishëm.

Në rastin e situatave të konfliktit të interesit, si p.sh. marrja e vendimit propozues për kancelarin, Komisionet e Ristrukturimit do t'i nënshtrohen rregullave të organeve kolegjiale, duke reflektuar në procesverbalet e mbledhjes vendimet e ndërmjetme apo vendimet e marra.

Neni 8 rregullon fazën përmbyllëse të procesit që lidhet me pranimin ose refuzimin e vendimit propozues të Komisioneve të Ristrukturimit nga nëpunësi/ punonjësi, si dhe vendimin përfundimtar të Këshillit aktual i gjykatës pritëse, apo KLGJ. Këta të fundit ia njoftojnë vendimin propozues menjëherë çdo nëpunësi civil gjyqësor dhe punonjësi të gjykatës, duke i kërkuar të shprehë me shkrim mendimin për pranimin ose refuzimin e vendimit propozues. Çdo nëpunës civil gjyqësor apo punonjës i gjykatës, ka të drejtë të shprehë me shkrim mendimin për pranimin ose refuzimin e vendimit propozues, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit propozues për transferimin e përhershëm në gjykatën pritëse, apo sistemimin në një gjykatë tjetër.

Në rast pranimi të vendimit propozues, Këshilli aktual i gjykatës pritëse, brenda 5 ditëve nga marrja e mendimit me shkrim, njofton me vendim përfundimtar nëpunësin/punonjësin për pozicionin ku transferohet.

Akti ka përcaktuar rastet kur nëpunësi mund ta refuzojë transferimin, vetëm në rastet kur:

a) gjendja e tij shëndetësore, e provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;

b) gjykata ku i propozohet të transferohet gjendet më shumë së 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil.

Refuzimi nga ana e nëpunësit e vendimit propozues të transferimit të përhershëm për arsye të tjera nga ato të përcaktuara më sipër përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil gjyqësor.

Në rast refuzimi, Këshilli aktual i gjykatës pritëse, ia ridërgon praktikën Komisionit të Ristrukturimit, i cili brenda 5 ditëve nga njoftimi, rishqyrton shkaqet e refuzimit dhe vendos në lidhje me statusin e nëpunësit. Për punonjësit e tjerë

gjyqësorë, zbatohen për aq sa është e mundur, parashikimet e vendimi si dhe dispozitat e Kodit të Punës.

Në projektvendim përcaktohet edhe hyrja në fuqi menjëherë dhe publikimi i tij në faqen zyrtare.

Gjithashtu në lidhje me përbërjen e Komisioneve të Ristrukturimit -

Komisioni i Ristrukturimit të gjykatave të apelit ushtron funksionet pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe përbëhet nga kryetarët/zëvendëskryetarët dhe kancelarët e gjykatave të apelit Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Gjirokastër dhe Korçë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisionet e Ristrukturimit për riorganizimin e gjykatave të rretheve gjyqësore ushtrojnë funksionet dhe përbëhen:

a) Pranë Gjykatës së Rrethit Dibër dhe përbëhet nga kryetarët/zëvendëskryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Dibër dhe Gjykatës së Rrethit Mat, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

b) Pranë Gjykatës së Rrethit Durrës, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Durrës dhe Gjykatës së Rrethit Kavajë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

c) Pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Krujë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

ç) Pranë Gjykatës së Rrethit Fier, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Fier dhe Gjykatës së Rrethit Lushnjë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

d) Pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër dhe Gjykatës së Rrethit Përmet, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

dh) Pranë Gjykatës së Rrethit Lezhë, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Lezhë dhe Gjykatës së Rrethit Kurbin, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

e) Pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Pukë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

ë) Pranë Gjykatës së Rrethit Korçë, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Pogradec, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

f) Pranë Gjykatës së Rrethit Kukës, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Kukës dhe Gjykatës së Rrethit Tropojë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisionet e Ristrukturimit për riorganizimin e gjykatave administrative ushtrojnë funksionet dhe përbëhen:

a) Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Korçë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

b) Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët respektivë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjirokastër, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu hyrja në fuqi e tij është e menjëhershme dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët mbi përmbajtjen e aktit të propozuar?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet vendimi.)

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Mbi miratimin e rregullores "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Mbi miratimin e rregullores "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër i cili është jo më pak i rëndësishëm se ato që kaluam, që ka të bëjë me miratimin e rregullores "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor". Ky projekt-akt është me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe do të relatohet nga zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit Kryetare!

Unë do të bëj një përmbledhje të shkurtër të relacionit, duke qenë se ai prej kohësh së bashku me projektvendimin ju është vënë në dispozicion për t'u njohur.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, të përgjegjshmërisë, administrimit dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor, ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e projektrregullores për zhvillimin e procedurave disiplinore për Kancelarin, Këshilltarin dhe Ndihmësin Ligjor. Ky akt që i paraqitet për miratim Këshillit është konceptuar si një akt normativ nënligjor, që synon plotësimin dhe përmirësimin e sistemit të llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë, konkretisht kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë.

Ky projekt akt-bazohet në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë", nenet 69 dhe vijues të ligjit nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 61, pika 2, shkronja ë), f) dhe j), 90 pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", neni 97 pika 1, shkronja c) dhe ç) të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si dhe në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil".

Referenca kryesore ligjore në hartimin e këtyre akteve normative ka qenë legjislacioni i shërbimit civil, duke synuar një përafrim maksimal të statusit të nëpunësit civil gjyqësor me nëpunësin civil. Kjo paketë aktesh normative është konsultuar me këshillat e gjykatave dhe me ekspertë të Këshillit të Evropës, dhe sugjerimet e opinionet e këtij të fundit janë reflektuar në secilin projekt-akt në të cilin misioni ka ndërhyrë.

Struktura e projektrregullores

Projektrregullorja është organizuar në 6 krerë, parashikimet e të cilëve janë përmbledhur si më poshtë:

KREU I - Në kreun e parë, të titulluar "Dispozita të përgjithshme", janë vendosur nene të cilat përmbajnë parashikime të përgjithshme në lidhje me procedurat disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë, sipas kësaj projektrregulloreje. Në nenin 1 është vendosur qëllimi i projektrregullores, i cili është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe rregullave më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë.

Në Kreun e dytë “Procedurat hetimore”, janë vendosur nene të cilat përmbajnë parashikime në lidhje me kriteret e pranueshmërisë të ankesës dhe shqyrtimin paraprak të ankesës, fillimin e hetimit disiplinor, pezullimin e hetimeve dhe të procedimit, marrjen në pyetje, dokumentacionin e hetimit, përfundimin e hetimit, mbylljen e hetimit, rihapjen e hetimit, si dhe ankimin e mosveprimit administrativ.

Në Kreun e tretë “Procedimi disiplinor” është rregulluar veprimtaria dhe mënyra e funksionimit të Këshillit gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor.

Në Kreun IV të projektrregullores parashikohen rregulla në lidhje me pezullimin nga detyra të nëpunësit civil gjyqësor ndaj të cilit ka filluar hetimi ose procedimi disiplinor.

Në Kreun V rregullohet procedura e ekzekutimit të vendimit për caktimin e masës disiplinore, e cila është në përputhje me parashikimit e Kodit të Procedurave Administrative.

Kreu VI, i titulluar “Dispozita të fundit”, parashikon rregulla në lidhje me modelin e formularit të ankesës, si dhe përmban një dispozitë kalimtare për kancelarët në detyrë, duke diferencuar procedurat disiplinore në varësi të fazës në të cilën ndodhet procedura e filluar në Këshill për verifikimin e kushteve dhe kritereve formale të pozicionit, figurës dhe pasurisë.

Ky është në mënyrë të përmbledhur përmbajtja e strukturuar në krerë dhe nene e projektvendimit “Për miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor””.

Për sa i përket strukturës, ky projektvendim përbëhet vetëm nga një pikë, ku në pikën 1 propozohet pikërisht miratimi i Rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Është parashikuar që ky vendim të publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe të hyjë në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Shehu për relatimin!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë gjë për të diskutuar mbi projekt-aktin.

Nëse jo, atëherë kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e Rregullores "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor".

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-udhëzimit "Mbi përcaktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm, dhe caktimit për një çështje të veçantë", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projekt-udhëzimit "Mbi përcaktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm, dhe caktimit për një çështje të veçantë", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë lidhur me përcaktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm, dhe caktimit për një çështje të veçantë. Për më shumë detaje do të ftoja drejtorin e Departamentit të Buxhetit, z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Këshilli i Lartë Gjyqësor në kuadër të përmbushjes së detyrimit të tij ligjor për nxjerrjen e akteve nënligjore që ligjet e paketës së reformës në drejtësi i ngarkojnë, ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e një udhëzimi që rregullon trajtimin financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemë delegimi, për transferimin e përkohshëm, caktimin e përkohshëm si dhe caktimin për një çështje të veçantë.

Bazuar në urdhrin e Kryetares së KLGJ-së nr. 112, datë 20.09.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e draft udhëzimit për përcaktimin e masës së kompensimit të gjyqtarit në skemë delegimi, të transferimit të përkohshëm ose të gjyqtarëve që caktohen përkohësisht në një gjykatë", u ngrit grupi i punës i cili ka përgatitur draft udhëzimin për trajtimin financiar të këtyre gjyqtarëve.

Në përfundim të hartimit të projekt-udhëzimit, grupi i punës ia ka dërguar për mendim të gjithë gjykatave të të gjithë niveleve për të marrë mendimin e tyre.

Gjithashtu, projekt-udhëzimi, së bashku me relacionin shoqërues, iu dërgua për mendim në detyrim të ligjit edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila me shkresën e saj të datës 14.11.2022 është shprehur që "i parë nga këndvështrimi buxhetor shprehemi pa komente për përmbajtjen e projektit për sa kohë që kosto financiare për caktimin e rregullave dhe kompensimit financiar përballohet brenda tavaneve të miratuar nga institucioni përkatës".

Draft udhëzimi është i përbërë nga 5 nënndarje dhe ka përfshirë 32 pika.

Në nënndarjen I, pikat 1 dhe 2, përcaktohet qëllimi i tij dhe subjektet të cilëve iu drejtohet.

Në nënndarjen II, pikat 3 deri 15, përcaktojnë përkufizimet lidhur me termat që do të përdoren në udhëzim.

Në nënndarjen III, përcaktohet shtesa e pagës e gjyqtarëve në skemë delegimi dhe ata të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, që nuk janë pjesë e kësaj skeme.

Në nënndarjen IV, pikat 20 deri 23, përcaktohet mënyra e kompensimit që do të ndiqet për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm apo caktimin për një çështje të veçantë, duke specifikuar edhe natyrën e shpenzimeve që do përballohen.

Në nënndarjen V, pikat 24-32, përcaktohet procedura për miratimin dhe kompensimin për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose caktimin e përkohshëm. Në të parashikohet edhe dokumentacioni vërtetues justifikues që do të paraqesë secili nga gjyqtarët për kompensimin financiar në rast delegimi.

Duke qenë se udhëzimi ka një efekt prapaveprues, është llogaritur edhe efekti financiar që është i përballueshëm nga buxheti. Ky buxhet do përballohet nga fondet e secilës gjykatë, në gjykatat ku gjyqtari është caktuar në mënyrë të përhershme.

Në pikën e fundit të udhëzimit parashikohet organet e përcaktuara për zbatimin e tij dhe monitorimin e zbatimit të saj nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm.

Kaq kisha. Faleminderit për vëmendjen!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen?

Nëse jo, atëherë, kalojmë projekt-udhëzimin

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord. Dua të theksoj vetëm që të gjitha sugjerimet dhe komentet që kishin kolegët u reflektuan në draft udhëzimin i cili është gati për miratim.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e Udhëzimit “Për përcaktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të gjyqtarit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm, dhe caktimit për një çështje të veçantë”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

***Pika 8 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për detajimin e buxhetit vjetor 2023, për sistemin gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit "Për detajimin e buxhetit vjetor 2023, për sistemin gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër shumë i rëndësishëm edhe ky, që ka të bëjë me detajimin e buxhetit vjetor 2023, për sistemin gjyqësor. Sërish ia jap fjalën drejtorit të buxhetit, që në mënyrë të shkurtuar dhe të përmbledhur, të na parashtrojë projektbuxhetin për vitin 2023.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), për vitin 2023. Ky buxhet është në vlerën 4,362,600 mijë lekë, i ndarë në tre programe buxhetore, programi 01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, programi 01140, “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, dhe programi 03310, “Buxheti Gjyqësor”.

Fondet buxhetore të miratuara për sistemin gjyqësor, për vitin 2023, rezultojnë më pak se sa kërkesat e paraqitura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranë Ministrisë së Financave, në vlerën 1,230,200 mijë lekë. Janë miratuar shtesë për sistemin gjyqësor 30 punonjës, për të cilët do bëhet detajimi i tyre në fillim të vitit buxhetor 2023.

Fondet buxhetore të ndara sipas programeve paraqiten si më poshtë:

Programi 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”. Fondet e miratuara për këtë program për vitin 2023 janë 324,700 lekë, krahasuar me kërkesat buxhetore prej 315,200 mijë lekë, paraqiten 9,500 mijë lekë më të larta, e cila ka të bëjë me kërkesën për numër shtesë të punonjësve që është kërkuar për administratën e Këshillit.

Në shpenzime korrente, ku përfshihen shpenzimet e personelit, shpenzimet operative, shpenzimet për transferta për individët, është në vlerën 309,700 mijë lekë, të cilat janë programuar të përdoren për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative: për materiale të zyrave të përgjithshme, materiale shërbime speciale, shërbime për të tretët, shërbime transporti, shërbime udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, shpenzime për detyrime dhe kompensime legale (kryesisht kjo ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë), si dhe shpenzime të tjera operative të cilat lindin sipas nevojës.

Në shpenzime të tjera korrente 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, është detajuar një fond i cili ka të bëjë me një fond të rimbursimit të pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike.

Në shpenzime kapitale është përcaktuar një rikonstruksion në vlerën 500 mijë lekë, e cila konsiston në rikonstruksionin e një zyre për protokoll arkivin në katin e parë. Të tjerat janë detajuar për blerje pajisje që konsistojnë në pajisje audio vizuale të identifikuara nga sektori përgjegjës për teknologjinë e informacionit; Në “Pajisje të tjera teknike” (përkthimi simultan, ku përfshihen monitorë interaktiv, mikrofona, kabinë

përkthimi, etj.); Në “Pajisje kompjuterike”, (SAN SWITCH); Në “Pajisje të tjera zyre”, që janë identifikuar gjatë procesit të programimit nga Sektori i Shërbimeve Administrative.

Programi i dytë është programi për “Mbështetje për teknologjinë e informacionit të sistemit të drejtësisë”.

Në këtë program janë detajuar fonde vetëm në shpenzime korrente, të cilët konsistojnë në: shpenzime paga dhe sigurime shoqërore dhe shpenzime operative.

Duke qenë se QTI-ja mbështetet nga KLGJ-ja duke u nisur edhe misioni i saj që ka (miratimi i politikave dhe vendosja e standardeve për teknologjinë e informacionit të sistemit të drejtësisë) dhe detyrimin që ka Këshilli për ta mbështetur atë nga strukturat e saj mbështetëse. Kështu kemi detajuar vetëm në shpenzime korrente.

Pjesa më e madhe e buxhetit të miratuar e zë buxheti gjyqësor (pra programi buxhetor 03310) që konsiston në aktivitetin e gjykatave të të tre niveleve.

Fondi buxhetor për vitin 2023, në këtë program, është miratuar në vlerën 4,025,000 mijë lekë, (shpenzime page, shpenzime sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime kapitale), të cilat krahasuar me kërkesën e bërë nga KLGJ-ja për shumën prej 5,264,600 mijë lekë është miratuar më pak, në vlerën 1,2. Me një fjalë e gjithë diferenca që thashë më sipër konsiston në programin e buxhetit të gjykatave dhe kryesisht në shpenzime kapitale.

Më poshtë, më hollësisht po kaloj në detajimin e fondeve për sa i përket këtij programi në shpenzime korrente.

Në detajimin e saj është mbajtur parasysh: Fondet buxhetore në shpenzime personelit të detajuar në shumën 2,689,700 mijë lekë. Kemi mbajtur parasysh alokimin e fondeve për këtë grup shpenzimesh gjatë dy viteve të fundit, kemi mbajtur parasysh numrin e punonjësve deri në fund të nëntorit dhe numrin shtesë të punonjësve e kemi kërkuar efektiv që kemi në sistem, duke u nisur nga disa vakanca që janë krijuar në trupën gjyqësore dhe disa vakanca që janë në administratën gjyqësore. Nisur edhe nga vendimi i Këshillit të Ministrave 495 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” i cili do të sjellë edhe një ndryshim në strukturën

organizative të gjykatës të cilat janë pjesë e këtij vendimi, të cilat do të kenë dhe efektin e tyre financiar.

Duke qenë që fondi është më i vogël sesa ne kemi kërkuar, i cili është kërkuar në bazë të treguesve që unë citova më sipër, dhe strukturës organizative dhe numrit sipas strukturës organizative të sistemit gjyqësor, fondi për shpenzime personeli është në vlerën 388,400 mijë lekë, të cilat mendojmë se i plotësojnë kërkesat e sistemit gjyqësor të gjykatave të tre niveleve për shpenzime personeli për vitin 2023. Megjithatë, në negociatat që janë bërë edhe në takimet konsultative me Ministrinë e Financave, në çdo rast Ministria e Financave ka shprehur gatishmëri për akordimin e fondeve shtesë në shpenzime personeli për shkak të plotësimit të mundshëm të vendeve vakante apo për shkak të ndonjë riorganizimi të gjykatave.

Në shpenzime për mallra e shërbime të tjera (në shpenzime operative), është detajuar shuma 611,300 mijë lekë, të cilat krahasuar me kërkesën në shumën 710,000 mijë lekë, janë miratuar më pak fonde në shumën 98,700 mijë lekë mijë lekë. Një shumë nga kjo shumë fondesh do të administrohet në KLGJ e cila do jetë e grupuar brenda të njëjtit program 3310, e cila të bëjë me disa nga aktivitetet si siguria e gjykatave, fondi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si dhe fondi për gjykatat të cilat nga ristrukturimi nuk do jenë më gjatë vitit 2023 dhe me përfundimin e tyre do t'i paraqitet një material KLGJ-së për të bërë një rishpërndarje të fondeve për vitin 2023.

Edhe në këtë grup shpenzimesh, në mënyrë analitike parashikohet të përdoren për materiale zyre të përgjithshme (ngrohje, pastrim, ndriçim, blerje materiale kancelarie) për sigurimin e një aktiviteti normal të gjykatës. Materiale të tjera dhe shpenzime speciale siç janë veshje uniforme (gjyqtarë, sekretarë), fletore zyrtare, blerje fondi librash etj. Si dhe shërbime për të tretët, shpenzime transporti, shpenzime udhëtimi dhe dieta, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, shpenzime për detyrime dhe kompensime (ku disa gjykata kanë paraqitur kërkesa për përballimin e shpenzimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si dhe sipas rastit të tarifave përmbarimore). Gjithashtu pjesë e këtyre fondeve është edhe vlera që do përdoret për mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe infrastrukturës mbështetëse për ICMIS ekzistues; shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit audio RDA nëpër sallat e gjyqit dhe suporti teknik

për programin “Backup Chain”; shërbim interneti për KLGJ-në dhe gjykatat si dhe Lidhja Dark Fiber; shërbimi i sigurimit të licencave të programit “M Files”; Shërbimi i mirëmbajtjes së programit financiar “Cloud”; Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes në gjykata; si dhe kemi ruajtur një shumë shpenzime në kuadër të hartës së re gjyqësore e cila do t’iu shpërndahet gjykatave sipas nevojave që mund të paraqesin gjatë ristrukturimit të gjykatave në vitin buxhetor 2023.

Fonde të tjera kemi detajuar në artikullin 606 transferta për buxhetin familjare dhe individët, janë detajuar në shumën 8,000 mijë lekë. Kjo kërkesë është përdorur kryesisht për të plotësuar kërkesat për telefoni celulare të gjykatave aty ku ato kanë shprehur kërkesa, si dhe lidhur me financimin e përfitimit të interesit të kredisë për blerje apartamenti me qëllim banimi për gjyqtarët sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore.

Kalojmë në grup shpenzimin tjetër atë të shpenzimeve kapitale (investime) artikulli 230 + 231 në fondet buxhetore të destinuara për aktivitetin e gjykatave.

Detajimi i fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2023, në shpenzime kapitale (investime) në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, sipas grupeve të investimeve dhe kodit të projektit, u krye duke mbajtur në vëmendje: Nevojat e përvitshme të shpenzimeve për pajisje elektronike të cilat garantojnë funksionimin normal dhe mënjanojnë riskun e ndërprerjes së funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, nevojat për pajisje zyre, kryesisht zëvendësimin e atyre të amortizuara dhe nevojat shtesë të lindura, plotësimin e nevojave për pajisje sigurie dhe projektin për sigurinë e gjykatave, plotësimin e nevojave për rikonstruksionet e pjesshme sipas kërkesave të gjykatave. Më poshtë, sipas pasqyrës dhe relacionit që ju të gjithë keni përpara, kemi paraqitur detajimin e fondeve buxhetore për 2023 duke u bazuar sipas natyrës dhe sipas emërimit të projekteve dhe kodit të projekteve të cilat janë të miratuara nga Ministria e Financave. Kështu në “Studime dhe Projektime” kemi detajuar në fond prej 58,600 mijë lekë. Ky fond është i destinuar për hartimin e projekteve të zbatimit për Gjykatën e Lartë në shumën 30,000 mijë lekë, Gjykatën e Apelit Tiranë në shumën 20,000 mijë lekë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në shumën 8,000 mijë lekë. Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i është detajuar fondi prej 600 mijë lekë për projektin e rikonstruksionit të dhomës së serverit, e cila nuk u realizua gjatë vitit 2022.

Në kodin “Ndërtime ndërtesash dhe rikonstruksion i plotë/pjesshëm” për vitin 2023 nuk janë detajuar fonde për ndërtime të reja për arsye se nuk kemi një projekt të miratuar, e cila ishte programuar për vitin që vjen për Gjykatën e Lartë por për mungesën e sheshit të ndërtimit (të gjithë jeni në dijeni) nuk u bë e mundur ky realizim i këtij projekti. Është ulur ky fond për arse se gjykata e apelit kishte paraqitur kërkesë por u realizua brenda këtij viti buxhetor me detajimin që u bë në shtator. Kështu që brenda fondit 56,500 mijë lekë janë përfshirë tetë gjykata të cilat kanë detajuar fonde si vijon: Gjykata e Lartë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Dibër, Durrës, Fier, Sarandë, Tiranë, Vlorë. Fondet e detajuara në vlerat si më lart, do të përdoren për punime rikonstruksioni të pjesshëm në godinat ekzistuese, si dhe për Durrësin, Fierin, Tiranën dhe Sarandën do të përdoren për përshtatjen e dhomës së serverit, në zbatim të “Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve”.

Një pjesë të rëndësishme në buxhetin e shpenzimeve kapitale (investime) në programin 3310 të gjykatave zënë edhe programet softuerë për gjykatat. Këtu është detajuar fond për projektin e dixhitalizimit të dosjeve të arkivit. Ky program ka filluar të implementohet që gjatë vitit 2022 dhe për vitin 2023 janë detajuar në vlerën 38,600 mijë lekë. Tjetër projekt që është detajuar fond është projekti për zhvillimin e një aplikacioni ueb për regjistrin elektronik të urdhrit të mbrojtjes në vlerën 3,000 mijë lekë.

Projekt tjetër që është menduar të financohet është projekti për zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, i cili është detajuar për vitin 2023 dhe është i shtrirë në disa vite siç e kemi miratuar edhe në dokumentin e PBA 2023-2025 për një periudhë 5-vjecare dhe fondi për 2023 është detajuar në vlerën 212,000 mijë lekë.

Tjetër fond që është menduar të detajohet është blerja e pajisjeve softuerë instalim dhe zhvillime të reja në sistemin ICMIS, po realizohet në kuadër të hartës së re gjyqësore që gjatë vitit 2022, dhe për vitin 2023 do të detajohet në shumën 30,500 mijë lekë.

Tjetër projekt në vlerën 2,400 mijë lekë është projekti aplikacioni për avokatët, i dizenjuar të përdoret për sisteme operimi iOS, Android për Smart Phone.

Program tjetër që është detajuar fond është projekti e-inspektori, për t'i mundësuar akses Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, akses në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Fondi i detajuar është 28,800 mijë lekë.

Tjetër projekt që është detajuar fond është projekti i nënshkrimit elektronik dhe të pagesave online, i detajuar në shumën 31,600 mijë lekë.

Blerje pajisje për infrastrukturën elektronike, është detajuar në shumën prej 20,000 mijë lekë e cila konsiston në blerjen e pajisjeve në infrastrukturën elektronike për të gjitha gjykatat që kanë shprehur kërkesat (për të gjitha gjykatat e të gjitha niveleve).

Po kështu kemi detajuar fondin 189,100 mijë lekë në "Blerje orendi dhe pajisje zyre" për të gjitha gjykatat e të gjitha niveleve.

Kemi detajuar fondin prej 173,100 mijë lekë për projektin e sigurisë në gjykata. Edhe kjo është e shtrirë në tre vite buxhetore.

Tjetër kod projekti është edhe blerja e mjeteve motorike për të plotësuar nevojat për automjete për sistemin gjyqësor sipas kërkesave që kanë paraqitur gjykatat e të gjitha niveleve dhe për vitin 2023 është programuar një shumë prej 30,000 lekësh.

Kështu, për sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Departamenti në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i paraqet seancës plenare miratimin e relacionit mbi detajimin e buxhetit vjetor 2023 për sistemin gjyqësor dhe të tavaneve buxhetore për vitin 2024 dhe vitin 2025, sipas pasqyrave bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.

Në pritje të pyetjeve të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ndonjë diskutim?

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e detajimit të buxhetit vjetor 2023 për sistemin gjyqësor (KLGJ, QTI dhe Gjykatat) dhe të tavaneve buxhetore për vitin 2024 dhe vitin 2025, në nivel programi, artikulli dhe njësie shpenzuese, sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur.

2. Miratimin e detajimit të fondeve buxhetore në programin 03310 Buxheti Gjyqësor, në Shpenzime kapitale (Investime) për vitin 2023, në nivel artikulli, projekti dhe njësie shpenzuese, sipas pasqyrës nr. 2, bashkëlidhur.

3. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e "Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2023", përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EWMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e "Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2023", përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin tjetër që ka të bëjë lidhur me miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional, akt i cili vjen për shkak të propozimit të Komisionit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, dhe do të relatohet nga zonja Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në 85/1 të ligjit nr.96/2016, duhet të miratojë çdo vit programin me listën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, për të cilët do të

kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit pasardhës, bashkë me përcaktimin e periudhës së vlerësimit.

Qëllimi i këtij programi është përgatitja paraprakisht e një plani pune me emrat e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2023, por kjo nuk nënkupton në vetvete, fillimin e procesit të vlerësimit për gjyqtarët e përfshirë në program. Miratimi i këtij programi iu shërben gjithashtu kryetarëve e kancelarëve të gjykatave, që të organizojnë punën për plotësimin e tabelave statistikore e dërgimin e tyre në KLGJ, brenda muajit janar, para se të fillojë procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar të përfshirë në këtë program.

Skema e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve është plotësuar tashmë me të gjithë aktet nënligjore dhe është tërësisht e zbatueshme për gjyqtarët në detyrë dhe gjyqtarët e komanduar në Gjykatën e Lartë.

Programi i vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2023 është hartuar i ndarë në 4 pjesë, si më poshtë:

I. Ecuria e procedurave të vlerësimit

Pas miratimit të akteve nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, KLGJ, mbi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, nga viti 2020 e në vijim, ka filluar:

a) Procedurat e vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, në zbatim të nenit 171, pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Këto procedura vlerësimi kanë filluar, pasi nga organet e rivlerësimit kalimtar, janë dërguar dosjet me aktet e vlerësimit profesional për gjyqtarët, vendimet respektive të të cilëve kanë marrë formë të prerë. Përgjatë 2 viteve, 2021 dhe 2022, Këshilli ka miratuar gjithsej 52 raporte vlerësimi me qëllim gradimi, duke përmbyllur procesin e vlerësimit etik-profesional për periudhën 2013-2016, për 52 gjyqtarë. Për 3 gjyqtarë të tjerë është deklaruar përfundimi i procedurës pa vendim përfundimtar, për shkak se objekti i saj ka qenë i pamundur, ndërkohë që janë ende pa u shqyrtuar në Mbledhje Plenare 5 projektraporte vlerësimi të përfunduara nga Komisioni, që i përkasin periudhës së gradimit. Vazhdojnë procedurat e vlerësimit me qëllim gradimi për 19 gjyqtarë.

b) Procedurat e vlerësimit 3-vjeçare, sipas programit të vlerësimit të miratuar për vitin 2021. Në këtë program ishin përfshirë për vlerësim 52 gjyqtarë. Konkretisht, me vendimin nr.177, datë 29.04.2021 të KLGJ ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 24 (njëzet e katër) gjyqtarë, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, pjesë e programit të vlerësimit 2021, kjo duke marrë në konsideratë rendin e përparësive të përcaktuar në pikën 4 të vendimit nr. 645, datë 23.12.2021. Në vijim me vendimin nr.371, datë 13.09.2022 të KLGJ, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional për 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarët e mbetur, pjesë e programit të vlerësimit. Në total nga 52 gjyqtarët pjesë e programit, ka filluar procedura e vlerësimit për 43 gjyqtarë, ndërsa për 9 (nëntë) prej tyre, kjo procedurë nuk ka filluar për shkak se 2 (dy) gjyqtarë nuk gëzojnë më statusin e magjistratit, 6 (gjashtë) gjyqtarë nuk ushtrojnë funksionin e gjyqtarit për shkak të aplikimit të masës së "Shkarkimit nga detyra", nga Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe 1 (një) gjyqtar është vlerësuar me procedurë të përshpejtuar të detyruar etik dhe profesional për vitin e fundit të ushtrimit të detyrës (viti 2019), për shkak të kandidimit për ngritje në detyrë. Nga 43 procedura vlerësimi 3-vjeçare që i përkasin periudhës së vlerësimit 2017-2019, Këshilli ka miratuar 5 (pesë) raporte vlerësimi. 3 projektraporte i janë përcjellë Mbledhjes Plenare dhe janë në pritje për shqyrtim, 2 projektraporte janë në procedura komunikimi gjyqtarëve e në pritje të kundërshtimeve përkatëse, ndërsa për 2 (gjyqtarë) procedurat janë të pezulluara. Vazhdojnë procedurat e vlerësimit 3-vjeçare për periudhën e vlerësimit 2017-2019 për 32 (tridhjetë e dy) gjyqtarë.

c) Procedurat e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar të vitit të fundit kalendarik për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë sipas nenit 25 të Ligjit nr. 48/2019 (dispozitë kalimtare e shtuar në ligjin 96/2016) dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 22.11.2019 "Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve". KLGJ ka miratuar 41 (dyzet e një) raporte vlerësimi të përshpejtuar të detyruar, duke plotësuar me nga 2 vlerësime 41(dyzet e një) gjyqtarë që kanë aplikuar për ngritje në detyrë. Për 1 (një) gjyqtar projektraporti i vlerësimit pritet të shqyrtohet nga mbledhja plenare, ndërkohë që vijojnë procedurat e vlerësimit për 7 (shtatë) gjyqtarë të tjerë.

d) Procedura për njohjen e nivelit të vlerësimit për 1 (një) gjyqtar të vlerësuar nga institucioni ku ka qenë i komanduar në përputhje me nenet 53, 58, 70 pika 4 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, procedurë e cila ka përfunduar me miratimin nga KLGJ të vendimit nr. 257, datë 15.07.2022.

e) Procedurën e vlerësimit 3-vjeçar për 1 (një) gjyqtar të komanduar në Gjykatën e Lartë, për periudhën e vlerësimit 2018-2020, e filluar për shkak të kërkesës për zgjatje të komandimit.

II. Përcaktimi i listës së gjyqtarëve dhe periudhës së vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2023.

Në zbatim të nenit 85 të Ligjit "Për statusin", programi i vlerësimit duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë vlerësimin etik dhe profesional në kohë të gjyqtarit. Objektivat për zhvillimin profesional të gjyqtarit, duhet t'i përgjigjen nevojave reale të dala nga vlerësimi i punës së tij, me qëllim që rekomandimet për përmirësim të jenë koherente dhe të mundshme për t'u realizuar. Inkoherenca midis vlerësimit dhe promovimit të gjyqtarëve duhet minimizuar gjithashtu. Nga ana tjetër, vlerësimi duhet të mbulojë të gjithë përvojën profesionale të gjyqtarit.

Bazuar në parimet e mësipërme, vlerësimi periodik i gjyqtarëve, kryhet 1 herë në 3 vjet për gjyqtarët me më pak se 15 vjet përvojë profesionale dhe 1 herë në 5 vjet për gjyqtarët që kanë përvojë profesionale mbi 15 vjet. Në kushtet kur periudha e rivlerësimit kalimtar 2013-2016, për efekt të ligjit, konsiderohet periudhë vlerësimi për gjyqtarin që konfirmohet në detyrë, vlerësim që përfundon me gradimin e gjyqtarit (niveli i vlerësimit), fillimi i vitit të parë mbi të cilin duhet të llogariten periudhat e mëpasshme të vlerësimit 3 apo 5-vjeçare, është viti 2017. Në datë 31.12.2021, është plotësuar periudha e vlerësimit 5-vjeçar, por, aktualisht është objektivisht e pamundur fillimi i vlerësimeve 5-vjeçare, për shkak të : i) numrit relativisht të lartë të procedurave të vlerësimit që vijojnë ende, konkretisht 60 (gjashtëdhjetë) procedura vlerësimi; ii) numrit të vogël të nëpunësve përgjegjës për vlerësimin të angazhuar në proceset e mësipërme të vlerësimit, 2 (dy) nëpunës përgjegjës; iii) nevojës për kryerjen e vlerësimeve të përshpejtuara të detyruara për gjyqtarët që rishtazi kanë aplikuar apo do të aplikojnë për ngritje në

detyrë apo lëvizje paralele, për të cilit sipas akteve që plotësojnë Skemën e Vlerësimit, fillimi i procedurave të vlerësimit ka përparësi; iv) kryerjes në të njëjtën kohë edhe të procedurave të vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë, për të cilët do të përcillen në vijim nga organet e rivlerësimit aktet e vlerësimit profesional, procedurë e cila duhet të fillohet gjithashtu me përparësi.

Nga ana tjetër, referuar të dhënave të marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore:

- nga gjyqtarët që ushtrojnë detyrën aktualisht në juridiksionin e apelit janë 26 (njëzet e gjashtë) gjyqtarë që kanë mbi 15 vjet përvojë profesionale, nga të cilët 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë kanë ose janë përfshirë në procedura vlerësimi bazuar në skemën e re të vlerësimit. Nga 11 (njëmbëdhjetë) gjyqtarët e tjerë, vetëm 7 (shtatë) prej tyre janë konfirmuar me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit kalimtar. Këta të fundit, nuk kanë aplikuar për ngritje në detyrë, ndërkohë që veç gradimit (2013-2016), kryerja e një vlerësimi tjetër 5-vjeçar (2017-2021), përveç se do të sillte një ngarkesë të papërballueshme për vlerësuesit, nuk përbën çështje prioritare për Këshillin.

- nga gjyqtarët që ushtrojnë detyrën aktualisht në juridiksionin e shkallës së parë janë 80 (tetëdhjetë) gjyqtarë që kanë mbi 15 vjet përvojë profesionale, nga të cilët 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë kanë ose janë përfshirë në procedura vlerësimi bazuar në skemën e re të vlerësimit. Nga 67 (gjashtëdhjetë) gjyqtarët e tjerë, vetëm 15 (pesëmbëdhjetë) prej tyre janë konfirmuar me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit kalimtar. Këta të fundit, nuk kanë aplikuar për ngritje në detyrë, ndërkohë që veç gradimit (2013-2016), kryerja e një vlerësimi tjetër 5-vjeçar (2017-2021), përveç se do të sillte një ngarkesë të papërballueshme për vlerësuesit, nuk përbën çështje prioritare për Këshillin. Në eventualitetin e aplikimit të tyre për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, ata do të jenë subjekt të vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit të vitit të fundit kalendarik.

Sa më sipër programi i vlerësimeve për 2023 do të përfshijë përsëri një periudhë 3-vjeçare vlerësimi, që përkon me periudhën kalendarike 01.01.2020-31.12.2022, duke përfshirë në vlerësim gjyqtarët për të cilët përfundon ose ka përfunduar periudha e vlerësimit në 31.12.2022. Për periudhën e vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022, do të vlerësohen të gjithë gjyqtarët që kanë mbi 3 vjet por jo më shumë se 15 vjet përvojë

profesionale në dt. 01.01.2023. Nga kjo kategori përfshihen në program, vetëm ata gjyqtarë që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional sipas skemës së re të vlerësimit.

Lista me gjyqtarët që do të vlerësohen përgjatë vitit 2023, për periudhën e vlerësimit 2020–2022 përbëhet nga 9 gjyqtarë: *(përmenden emrat e gjyqtarëve).*

Në këtë listë, nuk janë përfshirë gjyqtarët që janë aktualisht në procedurë vlerësimi për periudhën e vlerësimit 2017–2019, si dhe ndihmësmagjistratët e komanduar pranë Gjykatës së Lartë, në kushtet kur periudha e përfundimit të afatit 3-vjeçar të komandimit është data 20.10.2023.

Lidhur me periudhën e vlerësimit 2020–2022, nga lista e dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së, konstatohet se veç gjyqtarëve të listës si më sipër, nuk ka asnjë gjyqtar tjetër që plotëson së paku 3-vite përvojë profesionale në datë 31.12.2022, apo për të cilët nuk është filluar procedura e vlerësimit nga ana e Këshillit. Gjyqtarët e emëruar pas vitit 2019, nuk kanë plotësuar ende 3 vite përvojë profesionale për tu bërë subjekte vlerësimi.

Veç listës së mësipërme, programi i vlerësimit për vitin 2023 përmban edhe:

1) Gradimin e gjyqtarëve, të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, për të cilët do të dërgohen në vijim nga organet e rivlerësimit, aktet e vlerësimit të tyre profesional. Lidhur me fillimin e procedurave të vlerësimit me qëllim gradimi, ato do t'i propozohen për miratim mbledhjes plenare, menjëherë me dërgimin e dosjes së vlerësimit nga organet e rivlerësimit, sikundër është vepruar edhe përgjatë vitit 2022.

2) Vlerësim të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit që përkon me vitin e fundit kalendarik të ushtrimit të detyrës, në rastet kur do të kërkohet nga gjyqtari, ngritja në detyrë ose lëvizja paralele.

Pjesë e këtij programi vlerësimi, sikundër edhe në vitet paraardhës, nuk janë kryetarët e gjykatave, sepse aktualisht pjesa më e madhe e gjykatave drejtohen nga zëvendëskryetarët. Një numër i konsiderueshëm i kryetarëve të gjykatave janë shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

III. Planifikimi 3-mujor i vlerësimeve individuale

Në lidhje me planifikimet 3-mujore të fillimit të procesit të vlerësimit, në nenin 11 pika 1 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, është përcaktuar se: "Këshilli miraton

brenda muajit nëntor të çdo viti, programin vjetor të vlerësimeve etike dhe profesionale. Programi vjetor përmban, për aq sa është e mundur, edhe planifikimin tremujor të vlerësimeve.

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, planifikimet 3-mujore të vlerësimeve bëhen pjesë e programit të vlerësimit, për aq sa është e mundur. Duke marrë ne konsideratë situatën në të cilën ndodhen gjykatat për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave, vendet vakante që mund të hapen, kërkesat për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele, KLGJ-ja vlerëson që planifikimet 3-mujore të vlerësimeve të miratohen me vendim të veçantë të Këshillit, mbi bazën e të cilit do të fillojë edhe procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar, duke mos u ndarë në 3 programe të veçanta 3-mujore, kjo edhe për shkak të numrit të gjyqtarëve të planifikuar për tu vlerësuar gjatë vitit 2023, sipas listës së mësipërme.

IV. Prioritetet e planifikimeve 3-mujore

Prioritet e planifikimeve 3-mujore të programit të vlerësimit 2023, janë si më poshtë:

1. Kryerjen me përparësi të të gjitha vlerësimeve me procedurë të përshpejtuar të detyruar, sipas neneve 22 dhe 23/b të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019;

2. Gradimin e gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, bazuar kjo në nenin 23/a të vendimit nr. 263/2019;

3. Vlerësimin 3-vjeçar për periudhën 01 janar 2020 – 31 dhjetor 2022 për gjyqtarët e përfshirë në program.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim mbi përmbajtjen, ju ftoj që të kalojmë në votim

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Naureda Llagami: Marçela!

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Marçela!

Marçela Shehu: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.12.2022)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor" të datave: 04.10.2022 (2 mbledhje), 10.10.2022, 13.10.2022, 14.10.2022, 18.10.2022, 21.10.2022, 25.10.2022 (3 mbledhje), 27.10.2022, 01.11.2022, 02.11.2022, 03.11.2022, 04.11.2022, 07.11.2022, 14.11.2022 (2 mbledhje), 17.11.2022, 21.11.2022 (2 mbledhje), 24.11.2022 dhe 01.12.2022.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:36 dhe mbaroi në orën 15:19.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***

8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Etrita Petrit, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Edmond Hoxhaj, Katerian Çela.

7. Valbona Bala, eksperte EËMI.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

9. Media ABC-regjia.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor" të datave: 04.10.2022 (2 mbledhje), 10.10.2022, 13.10.2022, 14.10.2022, 18.10.2022, 21.10.2022, 25.10.2022 (3 mbledhje), 27.10.2022, 01.11.2022, 02.11.2022, 03.11.2022, 04.11.2022, 07.11.2022, 14.11.2022 (2 mbledhje), 17.11.2022, 21.11.2022 (2 mbledhje), 24.11.2022 dhe 01.12.2022.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i fundit për këtë mbledhje, që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht bëhet fjalë për mbledhjet e datave 04.10.2022 (2 mbledhje), 10.10.2022,

13.10.2022, 14.10.2022, 18.10.2022, 21.10.2022, 25.10.2022 (3 mbledhje), 27.10.2022, 01.11.2022, 02.11.2022, 03.11.2022, 04.11.2022, 07.11.2022, 14.11.2022 (2 mbledhje), 17.11.2022, 21.11.2022 (2 mbledhje), 24.11.2022 dhe 01.12.2022.

Procesverbalet ju janë shpërndarë nga administrata.

Nëse keni diskutime mbi përmbajtjen e tyre?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e tyre.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord, me përjashtim të datave 21.10.2022, 25.10.2022, 27.10.2022, në të cilat nuk kam qenë prezent.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 04.10.2022 (2 mbledhje), 10.10.2022, 13.10.2022, 14.10.2022, 18.10.2022, 21.10.2022, 25.10.2022 (3 mbledhje), 27.10.2022, 01.11.2022, 02.11.2022, 03.11.2022, 04.11.2022, 07.11.2022, 17.11.2022, 24.11.2022 dhe 01.12.2022 *(janë edhe datat të cilat nuk citohen gjatë leximit 14.11.2022 (2 mbledhje), 21.11.2022 (2 mbledhje)).*

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po përfundojmë mbledhjen për sot. Gjithashtu është edhe mbledhja e fundit për këtë vit. Ju uroj një vit të mbarë! Mirë u takofshim vitin tjetër!

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor